



REPUBLIKA E SHQIPÉRISË

**BASHKIA MALIQ**  
**KËSHILLI I BASHKISË**

Datë 30.06.2023

Prot.2 (dy)

Protokoll nr. 2

I mbajtur sot më datë 30.06.2023, në mbledhjen e radhës së Këshillit të Bashkisë Maliq, në sallën e mbledhjeve të këshillit të bashkisë, ora 10:00.

Rend Dite:

1. Hapja e mbledhjes (korumi, miratimi i rendit të ditës, vendimet e mbledhjes së kaluar);
2. Miratimin e raportit hartuar nga Komisioni i mandateve pranë Këshillit të bashkisë Maliq, për dhënien e mandatit të këshilltarit bashkiak z.Petrit Kupe dhe z.Ilia Xhuti, si dhe betimi i tyre;
3. P-V "Për miratimin e Ndihmës Ekonomike deri në masën 6% të fondit përmuanin maj 2023";
4. P-V "Për miratimin e Ndihmës Ekonomike nga fondi i bashkisë Maliq përmuanin maj 2023";
5. P-V "Për miratimin e marrëveshjes së bashkëfinancimit të projektit të përbashkët të Bashkisë Maliq dhe Këshillit të Qarkut Korçë, me qëllim "Mbrojtjen dhe përfshirjen sociale përmoshuarit";
6. P-V "Për miratimin e programit buxhetor afat-mesëm përvitet 2024-2026";
7. P-V "Për mbështetjen financiare të aplikantëve, banorë të bashkisë Maliq në vijim të programit të Qeverisë Shqiptare "Programi i Kodimit";
8. Diskutime të tjera.

**Këshilltarë të pranishëm në sallë:**

Ornildi Demollari; Pranvera Begolli; Rudina Bregu; Floreta Zaçe; Idlir Limllari; Enida Avdolli; Gentiana Drabo; Ilia Xhuti; Marianhi Avrami; Petrit Kupe; Fevri Sherifi; Dritan Çami; Ronaldo Skënderi; Daniela Ibrahim; Klea Baçi; Rovena Terolli; Yllson Ibrahimllari; Nersida Shindo; Server Xhuti; Albina Xhejo; Faslli Zholi; Eglantina Balli; Andonaq Risto; Aleksandra Spaho; Lulëzim Hoxhaj; 25 (njëzetë e pesë) këshilltarë.

**Të pranishëm nga Administrata:** Kryetari i Bashkisë: z.Gëzim Topçiu; Drejtore e Financës dhe Buxhetit: znj.Almira Muka; Punojëse e Sektorit të Shërbimit Social:znj.Alda Lenja

**Ornildi Demollari:** Fillojmë mbledhjen e radhës të Këshillit, me rend dite me 8 pikë, do kërkoja mirëkuptimin tuaj të bëjmë dhe një pikë shtesë, bëhet fjalë për një rast emergjent në fshatin Zvezdë.E kalojmë në votim rendin e ditës?





REPUBLIKA E SHQIPÉRISË

Kush është dakord me rendin e ditës, bashkë me shtesën?

Kundra?

Abstenim?

Korumi realizohet, Miratohet me 25 vota pro. Faleminderit!

**Ornildi Demollari:** Po lexoj vendimet e mbledhjes së kaluar.

**Vendim nr.63, datë 19.06.2023**

“Për zgjedhjen e komisionit të verifikimit të mandateve”

**Vendim nr.64, datë 19.06.2023**

“Për miratimin e mandateve të antarëve të këshillit bashkiak Maliq”

**Vendim nr.65, datë 19.06.2023**

“Për zgjedhjen e komisionit të votimit”

**Vendim nr.66, datë 19.06.2023**

“Për zgjedhjen e kryetarit të këshillit bashkiak Maliq”

**Vendim nr.67, datë 19.06.2023**

“Për zgjedhjen e Zv/kryetarve të këshillit bashkiak Maliq”

**Vendim nr.68, datë 19.06.2023**

“Për zgjedhjen e përfaqësuesve të këshillit të bashkisë Maliq në këshillin e qarkut Korçë”;

**Vendim nr.69, datë 19.06.2023**

“Për deklarimin e vlefshmërisë së mandatit të Kryetarit të Bashkisë Maliq Z.Gëzim TOPÇIU”;  
Këto ishin vendimet që kemi marrë në mbledhjen parë. Vazhdojmë me rendin e ditës, miratimin e raportit hartuar nga Komisioni i mandateve pranë Këshillit të bashkisë Maliq, për dhënien e mandatit të këshilltarit bashkiak z.Petrit Kupe dhe z.Illia Xhuti, si dhe betimi i tyre;

**Ornildi Demollari:** Janë dy kolegët që nuk ishin prezent mbledhjen e kaluar, do bëjnë betimin sot, stoj komisionin e mandateve dhe kryetaren e komisionit, ke fjalën.

**Pranvera Begoli:** Përshtendetje! Në mbledhjen e parë e konstituimit të këshillit bashkiak, nga 31 anëtarë sa ishte lista u betuan 29, 2 prej tyre do kalojnë sot. Komisioni i mandateve ka mbajtur raportin e vet që po ja u lexoj.

**RAPORT (Dhënie mandati)**

**Drejtuar: Këshillit Bashkiak**

Në zbatim ligjit nr.139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, nisi 49 “Mandati i këshilltarit” pika 1 dhe 2, nisi 50 “Betimi” pika 2, nisi 54 “Detyrat dhe kompetencat e këshillit bashkiak”, gërmë “j” dhe në zbatim të Rregullores së Këshillit Bashkiak Maliq miratuar me vendim këshilli nr.24, datë 12.03.2020, “Për miratimin e Rregullores së Këshillit të Bashkisë Maliq”, nisi “Betimi i këshilltarit”, vendimit nr.604 i KQZ Tiranë, datë 25.05.2023 “Për shpërndarjen e mandateve për Këshillin e Bashkisë Maliq” dalë nga zgjedhjet për qeverisjen Vendore të datës 14 Maj 2023, i cili përeakton mandatet të subjekteve politike sipas listës bashkangjitur si dhe vendimin e KZA-së nr.70



REPUBLIKA E SHQIPÉRISË

me nr.323 datë 16.05.2023 "Për miratimin e tabelës përbledhëse të rezultateve për zgjedhjet e Këshillit të Bashkisë Maliq"

Nga verifikimet e dokumentacionit, komisioni vërtetoi se mandatet janë fituar konform kërkesave të Kodit Zgjedhor dhe ligjit 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore" i ndryshaur. Ndaj i propozojmë këshillit bashkiak ,

Miratimin e raportit për dhënien e mandatit të këshilltarit z.Petriz Zylyf Kupe, z.Ilia Bashkim Xhuti kandidatë në listen shumëmërore të Partisë Socialiste të Shqipërisë, përgatitur nga Komsioni i Mandateve.

Sekretari i Këshillit të ndjekë procedurat e nevojshme ligjore.

**Pranvera Begolli:**Të dy anëtarët e këshillit duhet të bëjnë betimin, Peterit Kupe:

Betohem në nderin tim se do të kryej me ndërgjegje detyrën e anëtarit të këshillit bashkiak dhe do t'i bindem Kushtetutës dhe ligjeve. Betohem se në të gjithë veprimitarë time do të udhëhiqem nga interesat e shtetasve të bashkisë (*Maliq*) dhe do të punoj me ndershmëri e përkushtim për zhvillimin dhe rritjen e mirëqenies së tyre”.

**Peterit Kupe:**Betohem!

**Pranvera Begolli:**Ilia Xhuti:

Betohem në nderin tim se do të kryej me ndërgjegje detyrën e anëtarit të këshillit bashkiak dhe do t'i bindem Kushtetutës dhe ligjeve. Betohem se në të gjithë veprimitarë time do të udhëhiqem nga interesat e shtetasve të bashkisë (*Maliq*) dhe do të punoj me ndershmëri e përkushtim për zhvillimin dhe rritjen e mirëqenies së tyre”.

**Ilia Xhuti:**Betohem!

**Ornildi Demollari:**Faleminderit! Falenderojmë dhe kryetaren e komisionit të mandateve, ftoj kolegët të miratojmë, mandatin e kolegve tanë.

Kush është dakord me mandatin e kolegve tanë,

Kundra? Nuk ka.

Abstenim? Nuk ka.

Miratohet me 25 vota pro. Faleminderit!

**Ornildi Demollari:**Të dy kolegve z.Petriz dhe z.Ilia punë të mbarë dhe suksese në misionin tuaj të këshilltarit.Kalojmë te pika tjetër e rendit të ditës, P-V "Për miratimin e Ndihmës Ekonomike deri në masën 6% të fondit përmirësuar maj 2023"; Ka ndonjë pyetje për pikën 3 të rendit të ditës?

**Aleksandra Spaho:**Përshtendetje! Në lidhje me ndihmën e ekonomike, para disa ditësh kemi bërë një betim që do jemi në shërbim të komunitetit dhe kemi hasur një problem, ka të bëjë listën e ndihmës ekonomike nga sistemi, deklarimi që bëhet njëherë në 3-muaj.Ka shumë banorë që shkojnë përmirësuar punë sezonale 1-2 muaj, nga momenti që ata largohen ndihma ekonomike ju hiqet përmirësuar 6-mujore.Duhet të bëjmë diçka ne se i bashki dhe sot kisha një rast si ky, ku një familjar ishte larguar përmirësuar 3 javë, ai duhet të parqitet brenda datës 10 përmirësuar, kështu ai humbet të drejtën të trajtohet me ndihmë.Duhet të bëjmë diçka, ti drejtohem me shkresë



REPUBLIKA E SHQIPÉRISË


Ministrisë, Parlamentit.Kam dhe diçka tjetër lidhur me deklarimin, ka raste kur dikush nuk shkon për deklarim për arsy kujtese, punonjësit dy ditdy ditët e fundit ti kujtojnë me telefon,Të hartojmë një shkresë me jursitë në bashki, një zgjidhje duhet ti japim.Kur dikush largohet një muaj të penalizohet vetëm për atë muaj jo për 6 muaj.

**Ornildi Demollari:**E nderuar kolege, ndihma ekonomike është një ndihmë e përkohshme, nuk është se e ke gjithmonë, e ke të përcaktuar në ligj, ja jap fjalën Kryetarit të bashkisë për dy shqetësimet.

**Kryetari i Bashkisë: z.Gëzim Topçiu:**Përvetësime që gjithve!Në fakt është një shqetësim dhe për ne, dua të qartësoj tre momente dhe për Këshillin por veçanërisht për qytetarët dhe patjetër për ata që duan të jenë përfitues të ndihmës ekonomike.Ndihma ekonomike është për familjet që kanë nevojë për atë ndihmë, nuk realizohen të gjitha nevojat me të, por ligji është ligj.Nëse këshilli kërkon ti drejtohet Ministrisë të linjës, patjetër ka të drejtën, nuk e dimë sa do merret në konsideratë, por duhet të jemi të kujdesshëm dhe në kërkesat tona.Momenti i dytë që përmendi Aleksandara ishte që duhet tju çohet një mesazh, nuk është diçka e keqe, por nuk i dilet në këtë mënyrë.Qytetari që ka nevojë duhet të jetë vetë i interesuar për deklarimin në fillim të muajit.Por kur ata punojnë në të zezë dhe largohen në Greqi, ju duket sikur është një detyrim ndaj tyre për ti kujtar.Kush është forcë aktive duhet të shohë dhe mundësi të tjera, ne kemi filluar tani për një ndërgjegjësim të forcës aktive për punë, veçanërisht të grave, kemi punësuar 100 gra te Kompania Rozafa në Maliq, duhen dhe 300 gra të tjera, ku është i përfshirë dhe transporti falas.Por kjo nuk mund të ndodhë që ti refuzon sepese punon në të zezë, ligji këtë ka parashikuar të minimizohet skema.Ne jemi ndoshta nga bashkitë me numrin më madh në skemë.Sistemi i aprovar nga B.B, kur aplikon ose të përjashton ose të shpall fitues.Ne jemi të priruar ti ndihmojmë qytetarët ta marrin atë kompësim se ka familje që kanë realisht nevojë.Ne kemi bër dhe një propozim që të kthehet puna në komunitet, nëse një familje do të punojë me 4 orë ti japim një pagë 40.000 lekë duke punuar në pastrim ejt dhe atje do vijnë realisht ata që kanë nevojë, nuk do vijnë ata që fshehin të ardhurat e tyre pasi nuk mund të kapet çdo element.Problematikat janë shumë të mëdha dhe unë mendos se duhet të jenë disa propozime, ku bashkërisht ne, drejtoria përkatës e shërbimit social, këshilli dhe komisionet që do ngrihen shumë shpjjet, të bëjmë disa propozime konkrete për të mirën e përgjithëshme.Kjo është një problematikë që e hasim çdo ditë, kemi probleme nga më të ndryshmet dhe ne jemi të hapur ti zgjidhim, nuk i kemi parë politikisht asnjëherë.Faleminderit!

**Ornildi Demollari:** Faleminderit z.Kryetar!Po.

**Andonaq Risto:**Duke folur çdo ditë me qytetarët që përsitojnë ndihmë ekonomike, kemi hasur me një problem, kur një person kërkon ndihmë ekonomike dhe ka në pronësi një automjet nuk e përsiton.Dua të më thotë dikush që ka 4 fëmijë dhe i çon në shkollë dhe kurse, si mund ti çojë kur nuk ka një mjet? Ka dhe raste të tjera, makina nuk është më mjet luksi.



REPUBLIKA E SHQIPÉRISÉ

**Kryetari i Bashkisë: z.Gëzim Topçiu:** Ndihma ekonomike duhet të fillojë të minimizohet, ta marrë ai që vëretet i takon, ai që ka problem shëndtësore duhet të përfitojë PAK, këshilli nuk ka më kompetencë, e ka sistemiëshilli ndan vetëm fondin 6%, kur dikush ble një makinë 6-8 milion, ke të ardhura dhe nuk ke nevojë për ato lekë. Ligji e thotë që kur shkon në punë për 3 muaj nuk të hiqet ndihma, sa ta kuptosh a je në gjendje për atë punë, por duhet ta deklarosh. Shumicës të familjeve nuk ju takon të përfitojnë ndihmë ekonomike.

**Andonaq Risto:** Është e vërtetë që shumë familje i fshehin të ardhurat dhe përfitojnë ndihmë ekonomike, por unë them për atë pakicë që vërtet ka nevojë.

**Kryetari i Bashkisë: z.Gëzim Topçiu:** Jam i mendimit që çdo këshilltar të bëjë një propozim konkret me shkrim, që na ta përfshijmë në një dokumnet dhe ne tja përcellim Ministrisë.

**Ornildi Demollari:** Dua të ve theksin dhe te diçka, ai qështë një sistem i ndërtuar elektonikisht bazuar mbi ligjin 57/2019, është ndërtuar mbi një sistem pikëzimi onilne dhe nuk shumë hapësira për ndërhyrje, nëse kemi propozime të bëjmë dhe tja dërgojmë Ministrisë përkatëse.


**Aleksandra Spaho:** Nëse i doni me raste dhe emra konkretë jam e gatshme ti sjell, jam shumë jam dakord që personit që i ofrohet punë dhe refuzon të largohet nga ndihma ekonomike.

**Ornildi Demollari:** Faleminderit!

**Faslli Zholi:** I nderuar Kryetar i Këshillit, të nderuar Këshilltarë të dalë nga vota e qytetarve të bashkisë Maliq, i ndruar Kryetar i bashkisë, dua të falenderoj qyetarët që na kanë sjellë këtu në këtë sallë, në duhet të jemi të ndërgjegjshëm dhe të gjithë që jemi këtu pa dallime partiake duhet të bëjmë një transparencë. Problemi që ne po diskutojmë dhe dy këshilltrave që u betuan sot i uroj suksese dhe punë të mbarë këshillit. Por problemi që po diskutojmë sot për prblmet ekonomike, ne i dimë, me ndihmën ekonomike deri tani jemi të paqartë deri tani, nuk është zotësi e këshillit apo bashkisë të japi sa më shumë ndihma ekonomike. Detyra jonë është të bëjmë transparencë, të shohim sa lekë kemi. Jam dakorf që bëhet në sistem, po sistemin e bëjnë njerzit, ne duhet të jemi të ndërgjegjshëm të kemi njohuri kujt i takon ndihma ekonomike, të mos e përdorim politikisht, mendoj të japid propozime konkrete, ka familje që janë të punësuara dhe pëfitojnë ndihma ekonomike, kjo është përgjegjësi e drejtuesve të njësive vendore dhe ata që meren me këtë punë dhe zyrat ne të na japid një informacion për herën tjetër dhe të bëjmë transparencë me qyetarët se çfarë vendoset, ju faleminderit!

**Ornildi Demollari:** Faleminderit!

**Pranvera Begolli:** Kam kohë në Këshillin e bashkisë dhe ndihma ekonomike ka qenë problem gjithmonë, në momnetin që këshilli nuk e ka kompetencë ka vetëm fondin 6%, këshilltarët të informohen, jam me atë që tha kryetari i bashkisë, ju ofrohet punë dhe të gjithë mendojnë të amrrin pagesën e ndihmës. Nuk mund të jetë i paaftë për punë dhe të shkojë të punojë në Greqi dhe të vijë të kërkojë ndihmë ekonomike këtu! Duan të qëndrojnë në skemë për lehtësirat që ka, për librat falas, bursat etj, nuk mendojnë për sigurimet e tyre. Bashkitë e tjera kanë shume herë më pak qyetarë në ndihmë ekonomike, duhet pastruar lsita.



REPUBLIKA E SHQIPÉRISË

**Yllson Ibrahimlli:** Nisur nga problematika e diskutar, herën e kaluar kemi diskutar për përfaqësim në nivel grupesh, të kemi dhe një radhë mbarvajtje pune. Në mbështetje të fjalës të Kryetarit të bashkisë i cili thotë që varfëria nuk ka ngjyrë. Ne kemi disa mundësira të vogla, duke marrë në konsideratë dhe limitet që ne kemi këtu, ne nuk mund të marrim iniciativë ligjore, ne kemi një rregulllore këtu që flet qartë. Duke shfletuar për mbledhjen e sotme, gjej në faqen e këshillit bashkiak, komisioninë ndihmës ekonomike dhe stehimit me 7 anëtarë. Për qenë konçiz ky komision në mbledhje të vijë të na raportojë që kjo varfëri, në zonën tonë është thelluar dhe çfarë programesh mund të marrim, të bashkërendojmë grupet, askujt nuk i rëndon thjesht për të ngritur kartonin dhe nëse vijnë për tema kaq të ndjeshme vetëm me forcën e kartonit, unë e di që këtë që po diskutoj e kam të humbur. E para propzoj që gjitha listat e 6% të afishohen në çfo Nj.A. komisioni të raportojë, një grup këshilltarësh tëshkojë në NJ.A dhe të themi nuk ta ka hequr kryetari ndihmën, se nuk ka asgjë në dorë as këshilli nuk ta ka qehur, janë kriteret. Ndihma ekonomike ka filluar të aplikohet kur isha unë student dhe thuhej, kush ka disa pajisje eletroke shtëpiake nuk përfiton, ky është kriteri, tanë është kriteri i makinës, pak më vonë pak më vonë do diskutojmë dhe PAK e cila ka një ligj që është i viti 82, ku ka disa mangësi në përfitim. Varfëria është prezente në këtë zonë, them se ka vend për transparencë për vednimet që merren dhe kriteret, për të diskutar ku ndryshon lista, pse ka ndryshuar? Cila ishte arsyea? Mendoj se ka nevojë për tu përmirësuar kjo pjesë. Ju faleminderit!

**Ornildi Demollari:** Inderuar koleg faleminderit!

**Kryetari i Bashkisë: z.Gëzim Topçiu:** Listat ne ndihmës ekonomike dhe ndëryrjet e këshiltarve kanë qenë dhe politike ndonjëherë, ndaj dhe ligjëvënsi ja hoqi këtë kompetencë me një projket të Bankës Botrore dhe atje e kërkon kush mendon se përfiton, në bazë të disa kritereve ligjore. Këshillit i ka dhënë të drejtën të trajtojë disa familje nga fondi 6%. Po të shikoni vlerën është minimale nga 2000 lekë deri në 3000 lekë, familjet janë me një anëtar ose disa anëtarë, që e ulin %, ndaj dhe i ka dhënë kaq rëndësi ne kemi shtuar dhe një fond nga bashkia që e përdorim për raste të veçanta që nuk i plotësojnë kriteret. Mund të jetë një plakë e vetmuar, dy invalidë me probleme shëndtësore etj etj. Këshilli mund të hedhë ide, ajo çka unë zyngeroj se duhet të jemi shumë konçizë ta ajo që kërkojmë, se nuk bëhet fjalë vetëm për ne, po për gjithë Shqipërinë është ligj që nuk funksionon më vete dhe Këshilli nuk ka kompetencë që mund ta ndryshojë atë të drejtë e ka vetëm ligjëvënsi. Ndaj dhe ne le të mendojmë për propozime konkrete. Ajo çka nde duhet të jemi në një linjë është, ata që janë të aftë për punë duhet të punojnë. Sot kemi një mundësi ku ti çojmë për punë.

**Ornildi Demollari:** Faleminderit z.Kryetar! Ka ndonjë koment tjeter? E kalojmë në votim?

Kush është dakord?


Kundra? Nuk ka.

Abstenim? Nuk ka.

Miratohet me 25 vota pro. Faleminderit! Pika 4 e rendit të ditës, P-V "Për miratimin e Ndihmës Ekonomike nga fondi i bashkisë Maliq për muajin maj 2023"; Ka ndonjë pyetje?



REPUBLIKA E SHQIPÉRISË



**Faslli Zholi:**Sa është fondi?

**Kryetari i Bashkisë: z.Gëzim Topçiu:**Kjo është një praktikë e re që ne po zbatojmë për herë të parë këtë vit, me një fond prej 1 milion lekësh, që ne ja kemi dhë të drejtën Këshillit me vendimarrje sipas propozimeve që vijnë nga zyrat e ndihmës ekonomike, mund të ketë dhe propzoime nga këshilltarët duke ja çuar zyrës për ta parë, ka raste që familja nuk e përfston ndihmën ekonomike për një arsyesh ose tjetër, nuk është në skemë për mungesë pikësh, por në fund familja trajtohet, relacioni mendoj duhet të jetë më i plotë për familjet, pse trajtohet kjo familje, që ata ta kuptojnë arsyen.Vitin e kaluar dhe më parë trajtonim familje në nevojë në forma të ndryshme me vendimarrje.Këtë e kemi futur në një fond të veçantë të detikuar për këtë qëllim.

**Petrit Kupe:**Te cilit kriteri bazohet masa e ndihmës për këto 9 familje?, numri i familjarve apo kriteri ekonomik? Se shoh se ka shifra të ndryshme për çdo familje.

**Punojëse e Sektorit të Shërbimit Social znj.**Alda Lenja:Masa e përitimit të ndihmës ekonomike është e përcaktuar në ligjin 57/2019 dhe vkm-së 597 ku është e përcaktuar masa e përitimit për familjet duke qenë nga kryefamiljare dhe pjestarët e tjerë, është e bazuar ligj dhe udhëzimin nr. 2017 dhe masa është njëloj si për skemë, fondin 6% dhe fondi i bashkisë.Në bazë të anëtarave, 1800 lekë kryefamiljari, 1260 lekë bashkëshortja, 900 lekë anëtarët -18 vjet dhe 1260 lekë anëtarët 18.Në bazë të udhëzimit që ka nxjerë Minsitria është rritur me 20% vlera e ndihmës ekonomike.Të gjitha NJ.A kanë për çdo familje një dosje dhe relacion shpjegues pse kjo familje trajtohet.

**Ornildi Demollari:** Faleminderit!

**Aleksandra Spaho:**Kemi një rast në fshatin Sovjan, që nuk i ka të dy prindrit dhe gjyshrit nuk përfitojnë ndihmë ekonomike, fëmija është 8 vjeç.

**Kryetari i Bashkisë: z.Gëzim Topçiu:**Në këtë formë nuk dalim dot, këshilltarët çdo shqetësim që kanë, problematikë pranë zonave të tyre e adresojnë pranë sektorit të shërbimit social deh bëhet verifikimi sipas rastit.

**Faslli Zholi:**Jam dakord me atao që tha doktori, që nuk duhet të flasim të gjithë, por duhet të organizohemi me grupe dhe me komisione.

**Albina Xhejo:**Jam dakord me atë që tha Këshiltari më parë Andonaq Rrito i hiqet ndihma, sepse ka një automjet në pronësi, ka edhe raste që e përfshinë pa të drejtë kur gëzojnë shëndet të plotë kryefamiljarët.

**Ornildi Demollari:**Kualifikimin ose skualifikimin e bën sistemi, të përgatitim disa propozime konkrete, tja dërgojmë Ministrisë përkatëse.



REPUBLIKA E SHQIPÉRISË

**Kryetari i Bashkisë: z.Gëzim Topçiu:** Shqetësimi është me vend, ndaj ka dhe dy struktura, zyra e punës ku merr deklarim që nuk je në punë, zyra e punës të ofron vend pune, kur e refuzon duhet të largohesh nga skema, ndaj dhe ne duhet të ngulim këmbë në këtë punë, ndaj dhe ligjëvënsi ka vodosur disa kritere si rasti i makinës për të pastruar listën. Përgjegjësi mbajnë punonjësit e ndihmës ekonomike që kanë dosje për çdo familje që është në skemë dhe është pjesë e kontrolleve. Ju keni të drejtë të vodosni kritere kush do përftojë nga fondi 6%.. kush nga fondet bashkisë. Të ngrihen Komisionet dhe të flitet në emër të grupeve dhe sipas fushave, strehimi, ndihma ekonomike, mjekësia, financa etj. Të jepet mendimi i gruoeve ku dojenë të përfshirë në kë komision.

**Lulëzim Hoxhaj:** Jam plotësisht dakord me mendimin e kryetarit dhe të disa parafolsve që këtë problem që është shumë sensitiv nuk zgjidhet duke ngritur probleme, sistemi është ai që i zgjidh, ne mund të bëjmë propzoime për të forcuar sistemin jo për tu futur në sistem dhe për mendimin tim sa më pak kompetenca të kemi ne si këshill lidhur me këtë situatë aq më mirë është. E dyta lidhur me 3%, këtë herë jam dakord me propzomin ta miratojmë, por ky 3% nuk është fond për ndihmat ekonomike, kam frikë se ky fond është për emergjencat i përcaktuar me ligj për emergjencat, janë gjëra të ndryshme.

**Kryetari i Bashkisë: z.Gëzim Topçiu:** Fondi i emergjencave është tjetër, por ligjëvënis kur ka miratuar ligjet dhe udhëzimet përkatëse për ndihmat ekonomikeka vodosur dhe një pikë pushteti lokal mund nuk e ka detyrim, mund të caktojë një fond nga fondet e veta që për një kontigjencë të caktuar ti ndihmojë, do ketë raste që mund të mos ketë familje, ndaj dhe duhet të ketë kritere kush e përsiton, familje të cilës i ka ndodhur një fatkeqësi dhe nuk kishte mundësi të trajtoheshe në skemë dhe nga fond 6%. Ky fond quhet fond social.

**Lulëzim Hoxhaj:** Fondi 3% të bashkohet me atë 6%, ne si këshill duhet të qëndrojmë sa më larg këtyre problemeve. Faleminderit!

**Ornildi Demollari:** Faleminderit! Ka ndonjë koment tjetër? E kalojmë në votim?


Kush është dakord?

Kundra? Nuk ka.

Abstenim? Nuk ka.

Miratohet me 25 vota pro. Faleminderit! Kalojmë te pika 5 e rendit të ditës, P-V "Për miratimin e marrëveshjes së bashkëfinancimit të projektit të përbashkët të Bashkisë Maliq dhe Këshillit të Qarkut Korçë, me qëllim "Mbrojtjen dhe përfshirjen sociale për të moshuarit": Kryetari i Bashkisë ke fjalen.

**Kryetari i Bashkisë: z.Gëzim Topçiu:** Është një fond me një bashkëpunim që ne kemi me Këshillin e Qarkut Korçë, ata na aknë aprovar fondin për të hapur një qendër ditore për të moshuarit kemi hapur një tē tillë në qytetin e Maliqit, jemi duke menduar tē hapim dhe një në Drithas dhe shpresojmë që këto qendra tē hapim në qendrat më të mëdha administrative posynojmë Pojan, Vreshtas, Pirg dhe problematika e momentit është mungesa e ambjneteve, tē kemi mundësi tju shërbejmë me një kafe me një çaj të moshuarit, veçanërisht në sitnën e dimrit. E



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

kemi zbatuar vitin e kaluar, atje ka një punonjse që shërben për të moshuarit, shtë një praktikë e zbataur dhe në bashki të tjera dhe OJF të ndryshme si Dorkas na vjen në ndihmë, pse mos kemi në çdo fshat edhe pse ka kosto të madhe.Kërkohet vetëm një miratim nuk janë fondet tonë, janë fonde të Këshillit të Qarkut Korçë, të cilin e falenderojmë, që është bërë pjesë e një suporti të tillë për tju shërbyer të moshuarve.

**Ornildi Demollari:** Faleminderit z.Kryetar! Ka ndonjë koment tjeter? E kalojmë në votim?

Kush është dakord?

Kundra? Nuk ka.

Abstenim? Nuk ka.

Miratohet me 25 vota pro. Faleminderit! Kalojmë te pikë 6 e rendit të ditës, P-V "Për miratimin e programit buxhetor afat-mesëm për vitet 2024-2026": Kryetar do shpjegosh diçka, apo do shpjegojë drejoresha?

**Kryetari i Bashkisë: z.Gëzim Topçiu:**Në parim do them diçka, pastaj nëse ka pyetje, është një detyrtim ligjor për ta kaluar miratimin e programit buxhetor afat-mesëm për vitet 2024-2026, nuk marri një vendimarrje sot për ndarje fondesh sipas programve dhe strukturave, por qeveria vendos tavane boxhetore nga njëri vit te tjetri dhe ne bëjmë rishpërndarje sipa programve buxhetore, ashtu si i shikoni në informacion të shkurtër që ne ju kemi prezantuar, transferta e bashkisë Maliq në vitin 2024 do jetë 853.985 mijë lekë, vitin 2025 879.101, viti 2026 908.697 dhe kjo transfertë që pëson rritje nga viti në vit është si efekt i tavaneve apo rritjeve që qeveria parashikon tek transferta pakushtëzuar që ne na jep nga një vit në tjetrin.Pjesa e të ardhurave ne e mbajmë të njëjtë nga një vit në tjetrin dhe pastaj kur vjen miratimi i buxhetit, në parshikojmë në varësi dhe takasve dhe tarifave që atje miratojmë, shesa apo pakësime të duhura.Nëse doni një informacion sa është transferta e pakushtëzuar sa është buxheti, apo transferta e specifike, sektoriale.Ju kemi dhënë një shpenzim buxhetor të vitit 2024, për paga shpenzime operative dhe investime, ashtu dhe për vitin 2025 dhe 2025.Kjo është miratuar nnga këshilli i mëparshëm, pasi miratohen disa afate, i është çuar Minsitrisë përmirartim dhe Ministria Financave pas miratimit nga këshilli bashkiak, çon dhe propozime dhe mendime dhe mendimet që ne na kanë ardhur jemi Brenda kuadrit ligjor të miratuar nga qeveria përvanet buxhetore.Sygjerohet që duhet të jemi më të kujdeshëm në rritjen financimit për investime në territorin e bashkisë, sygjehet që të ardhurat të vilen më mire taksat dhe tarifat ato që mbulon bashkia, pasi kjo ta bëjë me investime dhe shërbime të tjera ndaj komunitetit.Jemi nga bashkitë që marrim një dakordësi nga Ministria Financave përfshiktuar që përfundimisht nuk ka fund vit do shihet nga ana jonë përvatuar në considerate, vendimarrja është e detyrueshme, pasi dhe nga ana ligjore përvatuar që parashion dhe ligji i buxhetit dhe ligji përfundimtar që parashion vendore.Shumë faleminderit!

**Ornildi Demollari:** Faleminderit z.Kryetar!Drejtoreshë ke diçka? Ka ndonjë pyejte tjeter?



REPUBLIKA E SHQIPÉRISË


**Yllson Ibrahimllari:** Kjo është diçka e miratur dhe nga Këshilli i kalaur, por besoj se do ketë dhe dakortësinë tonë për të vazhduar, por themelore në vazhdën e komisioneve që do ngremë dhe punve që na presin. Do krijohet komisioni i Ekonomisë ose raportimit në nivel drejorish, do doja të kishim një inventarizim të të gjithë aseteve të bashkisë, në total është një punë goxha voluminoze, është gati e vështirë, mbase mund të dalim me një propozim për një kompani që mund ta menaxhojë, sepse nuk dimë të ardhurat, sa lekë nxjerim. Në janar mos miratojmë Projekt-Buxhet të paditur se kush janë, inventarizimet, asetet themelore të bashkisë nga Dushari në Podgorie, Zëmbjak dhe Velçan të Gorës. Duke ditur astetet, duke ditur cilat janë ardhurat reale të që hyjnë nga bizneset, na duhet një informacion për bashkinë dhe pastaj dhe në kuadër të decendralizimit mund të kemi më shumë incitative për limitime të fondit buxhetor. Faleminderit!

**Ornildi Demollari:** Inderuar Këshilltar të gjitha të ardhurat dhe të gjitha operacionet ekonomike të bashkisë janë të publikuara në faqen e bashkisë.

**Yllson Ibrahimllari:** Inderuar kryetar po ju them sa është vlera e rezervuarit të Këmbëthekrit? Është aset sot i painventarizuar nga Drejtoira e Ujite Kullimit tuaj.

**Kryetari i Bashkisë: z.Gëzim Topçiu:** Është problematika më emadhe që ka çdo bashki, nuk është se nuk kemi një listë të pronave që ka bashkia, kemi një inventarizim të të gjithë pronave, ka edhe probleme se inventarizimi të çdo prona të NJ.A e kanë bërë ish Komunat. ne kmi një vendim qeverie për çdo NJ.A me të gjithë listën e inventareve të pronave, prona të cilat kanë hyrë në rregjistrin publik tonin dhe tani ne duhet ti rregjistrojmë këto prona, por që ti rregjistrosh pronat është një vlerë shumë e madhe financiare, për rregjisituar proant ndiqet e njëjaa procedurë ashtu si e bën privati me pagesë pranë kadastrës, vetëm ashtu quhet prona e jotja për ta dhënë me qira ose ekzekutuar. Dhe ne kemi filluar të bëjmë rregjistrim të pronave sipas kërkeseve që kanë qytetarët apo bizneset, problematika janë nga më ndryshmet, ne kemi një zyrë në bashki të rregjistrimit të pronave. Unë jam shumë dakord që ne na duhet dhe një kompani e cila kërkon vlera financiare për ta realizuar. Duam të bëjmë një plan rilevimi të të gjithë tokave bujëqsore edhe pse janë private, gjithë fusha e Maliqit që është aseti më i madh i pronave tona me kanale me rrugë, toka bujëqsore, kjo eleminon dhe konfliktet që kanë fermerë. Nuk e kemi detyrim, por ne duhet të zgjidhim problematikën që ata kanë me njëri-tjetrin. Me planin e rilevimit të të gjithë pronave të tokës bujëqsore të fushës ne zgjidhim shumë probleme nga taksat, pstrimi i kanaleve dhe në prona të tjera ka probleme, ka NJ.A që kanë inventarizuar prona që nuk bëjnë punë dhe kanë lënë ato që hynë në punë. Ne jemi duke përgatitur dhe një informacion që mund të bëjmë një shtesë të pronave në të gjithë NJ.A atje ku ka patur problematika. Jemi duke menduar dhe kjo është lënë dhe detyrë nga KLSH që me axhimi i pronave, zhvillimi i kësaj zyre apo drejtoria në të ardhmen është shumë e rëndësishme, e para për ti rregjisituar dhe për sjellë ardhura për ne dhe komunitetin, është problematikë që kërkon aktivizmin e të gjithëve dhe të këshillit në vendimarrje e tij, jam shumë dakord.

**Ornildi Demollari:** Faleminderit z.Kryetar!



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**Yllson Ibrahimlli:** Nuk e kisha fjalën për godinën e bashkisë Maliq për hipotekë, por për pronat e tjera se kur dimë vlerën e pronës, dimë dhe vlerën e qirasë ose tjetërsimin e saj në një moment të dytë.

**Petrit Kupe:** Ne si këshilltarë dhe veçanërisht ne si të rinj kemi nevojë për informacion shtesë, por që mos dalë nga tema të miratojmë buxhetin për vitet në vijim dhe në një pikë tjetër të fundit bëjmë një debat të lirë për rregjistrimin e pronave dhe probleme të tjera që duam ti njohim.

**Ornildi Demollari:** Dakord shumë e drejtë. Ka ndonjë koment tjetër, për projket buxhetin asfemesëm? E kalojmë në votim?

Kush është dakord?

Kundra? Nuk ka.

Abstenim? Nuk ka.

Miratohet me 25 vota pro. Faleminderit! Kalojmë te pika 7 e rendit të ditës, P-V "Përmbështetjen financiare të aplikantëve, banorë të bashkisë Maliq në vijim të programit të Qeverisë Shqiptare "Programi i Kodimit"; Janë disa studentë që janë rregjistruar te ky kur që quhet Program Kodimi dhe bazuar mbi ligjin kërkojnë mbështetje financiare nga bashkia.

**Gentiana Drabo:** Mund të ndaj diçka në lidhje me këtë? Faleminderit! Ashtu si e thatë dhe ju janë disa nxënës që kanë aplikuar personalisht për të fituar disa bursa trajnimi, të cilat i kanë fitaur edhe duhet të them që jemi me fat që kemi nxënës të tillë kaq të aftë, mbështetja duhet të jetë patjetër dhe përmë tepër nga sa pashë unë nga tabelat financimi për trajnimin e nxënsve do bëhet duke hequr nga shpenzimet e pritjeve dhe aktiviteteve, jo nga shpenzime që lidhen me çështje ekonomike, mendoj që ja vlen ta miratojmë.

**Ornildi Demollari:** Faleminderit Genta! Po kryetar!

**Kryetari i Bashkisë: z.Gëzim Topçiu:** Dua ta vlersoj dhe tju jap pëshë të rinjve që janë pjesë e kësaj fushe, ne para pak koshësh kemi mbështetur të rinj të ndjekin kurse trajnimi, programimit. Më vjen shumë mirë që ka nga të gjitha NJ.A, këta tre kanë dalë fitues në Qarkun e Korçës, 50% e mbulon qeveria shqipëtare dhe 50% ne ishim shumë gatshëm për ta mbuluar dhe shpresojmë të kemi të rinj të talentuar dhe të janë pjesë të administratave tona, pasi kemi shumë nevojë.

**Petrit Kupe:** Vlersoj iniciativat për mbështetjen e të rinjve dhe në kuadër të masave që morri qeveria duke stimuluar studentët ekselentë dhe studentët e tjerë me një pagë minimale 40.000 lekë, por nuk jam i qartë se çfarë përitojnë nxënsit te ky trajnim? Pse trajnohen?

**Kryetari i Bashkisë: z.Gëzim Topçiu:** Teknologjia ka avancuar për ne të gjithë, ajo që unë mendoj kjo është një nisëm e qeverisë qëndrore për zgjedhur elementët më të ditur nga çdo bashki dhe tre janë nga bashkia Maliq. Kur më ka ardhur propozimi nga zyra Rajonale e Punës të kaq qenë dakord, në bazë të performancës ata ishin tre nga më mirët e zonës dhe unë në këto kushte rrashë dakord. Propozimin e kishim para zgjedhjeve, por e lamë ta propozonim në këshill pas zgjedhjeve.



REPUBLIKA E SHQIPÉRISÉ

**Ornildi Demollari:**Kualifiokohen në elektronikë, IT, programim dhe kodim programesh.

**Gentiana Drabo:**Bëhet fjalë përaftësim në kodim dhe programim, këto asete në një kohë tjetër ne na kthehen përsëri, kjo është e veçanta e ekselentit.

**Ornildi Demollari:**Faleminderit! Ka ndonjë pyetje tjetër?

**Server Xhuti:**Ta mbështetim këtë kategori dhe urojmë të kemi sa më shumë.

**Ornildi Demollari:**Dakord shumë e drejtë. E kalojmë në votim?

Kush është dakord?

Kundra? Nuk ka.

Abstenim? Nuk ka.

Miratohet me 25 vota pro. Faleminderit! Tani jemi te pika që ju fola në fillim të mbledhjes, është një rast për një familje në fshatin Zvezdë.

**Server Xhuti:**E njoh rastin se e kam banor të fshatit dhe jam dakord që ai ta marri ndihmën, jemi pro.

**Ornildi Demollari:**Jemi duke e mbështetur ne me fuqi dhe bazë materiale për ndërimin e shtëpisë, me programin e strehimit, z. quhet Nazmi Gjata banor i fshatit Zvezdë.Ju ftoj ta kalojmë në votim?

Kush është dakord?

Kundra? Nuk ka.

Abstenim? Nuk ka.

Miratohet me 25 vota pro. Faleminderit!Tani para se të shkojmë te diskutime të tjera, duhet të fillojmë diskutimet për ngritjen e komisioneve bazuar në ligjin 139/2015 Për vetëqverisjen vendore dhe rregulloren e këshillit, duhet të ngrihen komisionet të cilat në bazë të rregullores janë 14 kjo është në varëtsi të bashkive.Drejtuesit e grupeve të këshillit duhet të kooredinohen me njëri-tjetrin që në një mbledhje të radhës të sjellin përfaqësuesit për çdo komision.Më lejoni tju përcjell komisionet të përcakuara në rregulloren e këshillit.

1. Komisioni i Mandateve, Rregulloreve, Çështjeve Juridike, Qeverisjes së Mirë, Administratës, Zgjedhjeve, Strukturave Komunitare.
2. Komisioni i Etikës, Standarteve dhe Apelimeve.
3. Komisioni i Financave, Buxhetit, Pasurive Bashkiake, dhe Planifikimit të Zhvillimit Strategjiktë Bashkisë, Mbikqyrjes Financiare.
4. Komisioni i Shërbimeve Publike, Transportit, Lëvizshmërisë Mjedisore, Parqeve dhe Rekreacionit, Parkingjeve.
5. Komisioni i Ekonomisë Vendore, Turizmit dhe Zhvillimit Rural.
6. Komisioni i Zhvillimit Hapësinor, Infrastrukturës dhe Strehimit.
7. Komisioni i Sigurisë Publike, Emergjencave Civile dhe Rehabilitimit.



REPUBLIKA E SHQIPÉRISÉ



8. Komisioni i Mirëqënies Sociale, Rinisë, Barazisë Gjinore, Mosdiskriminimit, Drejtave të Njeriut.
9. Komisioni i Shëndetësisë, Veterinarisë, Mjedisit dhe Mbrotjes së Konsumatorit.
10. Komisioni i Bujqësisë, Pyjeve, Menaxhimit të ujrale, Mbrotjes së Mjedist dhe Biodiversitetit.
11. Komisioni i Arsimit, Sporteve dhe Çlodhjes.
12. Komisioni i Kulturës, Trashëgimisë Kulturore, Dhënes së Titujve, Emërtimeve.
13. Komisioni i Qeverisë Elektronike dhe Teknologjisë së Informacionit.
14. Komisioni për Marrëdhënjet me jashtë dhe Integrimin Europian.

**Kryetari i Bashkisë: z.Gëzim Topçiu:** Unë mendoj që Sekretari i Këshillit duhet të bëjë një projekt e ka listën e Këshilltarve sipas arsimit dhe profesionit dhe pastaj vetë grupet lëvizin sipas nevojave. Ajo çfarë unë mendoj është që këshilli duhet të përcaktojë numrin e anëtave të komisioneve, këshilltarë të jenë sa më shumë efektivë atje ku janë.

**Yllson Ibrahimlli:** Mendoj se ne duhet të shtojmë disa komisione të tjera, jo ti zvogëlojmë ata. Sekretarit ti jepe lista me komisionet nga grupet dhe me propozimet përkatëse. Për sa përket rregullores të cilën ju keni mirautar në datë 12.03.2020, neni 11 ka 5 këshilltarë komisioni i mandateve duhet të bëjmë një ndryshim se ne kemi me 3 aktualisht ose ti shtojmë anëtarët.

**Ornildi Demollari:** Dakord në mbledhjen e radhës kryetarët e grupeve të vijnë me propozime konkrete.

**Kryetari i Bashkisë: z.Gëzim Topçiu:** Kam një propozim, që Sekretari i Këshillit të bëjë një moket të komisioneve, duke bërë një shpërndarje sipas shkollës profesionit për të gjithë komisionet. Interesi është i përbashkët të jenë sa më funksionalë komisionet.

**Ornildi Demollari:** Jemi dakord parmisht kështu, se kjo nuk ka nevojë për miratim.

**Aleksandra Spaho:** Kush e zgjedh kryetari ne Komisionit?

**Sekretari i Këshillit: Gertjan Gjiriti:** Kryetari ne Komisionit e zgjedh vetë komisioni.

**Faslli Zholi:** Për sa i përket komisioneve do dalim me një qëndrim të përbashkët sipas grupeve që jemi, mendoj se ne përfundim të mbledhjes të bëjmë një konsultë që herën tjetër ti kemi të plotësaura komisionet sipas rregullores. Kam dhe diçka tjetër, çfarë është bërë me fatkeqësitë natyrore? Zëmblik dhe a ka familje të rezikuara po kështu dhe grurin se jemi në pragdhe të korrjes, është bërë evidentimi? Kam edhe diçka tjetër lidhur me urën e Dusharit? Dua të di sa drejtori ka bashkia? Të shohim mundësinë si këshill ose si bashki për çmimin e grurit se është shumë i ulët. Faleminderit!

**Ornildi Demollari:** Këshill nuk mund të diktojë në rritjen e çmimit.



REPUBLIKA E SHQIPÉRISË



**Kryetari i Bashkisë: z.Gëzim Topçiu:** Ke të drejtë, mbasse duhet tju kisha dhënë një informacion unë për situatën në fshatin Zëmlak, ishte një situatë shumë e vështirë edhe sipas viteve më parë, por ne duhet të bëjmë punën tonë, nuk patur dëmtime të mëdha në njerës, prona private, por ka patur dëmtime të mëdha me infrastrukturën e fshatit argjinaturat, pritat, kanlet, rrugë të cilat ishin në gjendje shumë vështirë. Kemi stabilizuar deri diku situatën, kemi dy javë që po punojmë me mjete tona, forca njerzore por dhe me mjete private. Situata për momentin është e stabilizuar, por jo si ishte më parë, jemi duke hartaur një projeket-preventiv me të gjitha dëmet e shkatuara, ditën e djeshme kemi patur dhe një grup nga Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile e vila do të ketë një financim për stablizimin e situatës në Zëmlak dhe Plasë. Do ju sjellim shumë shpejt në Këshilli për të miratuar atë çka do i kërkojmë Ministrisë përakatëse dhe Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile, mbështetje financiare për ta stabilizuar situatën me investime kapitale dhe shpresojmë do realizojmë shumë shpjet. Në lidhje me urën e Dusharit, vërtet është një situatë e vështirë atje, ju e dini më mirë se unë, është një zonë gjeologjike jo e qëndrueshme, po ecim në dy linja sot që flasim atje kanë shkuar mjetet e Devolli Hydropower, të cilat janë në ndihmën tonë për të stabilizuar situatën dhe për ta bërë të kalueshme. Nga ana tjetër kemi kërkuar ndihmë për një studim gjologjik të të gjithë zonës dhe shpresojmë që do kemi një ndërhyrje të shpjetë me mjetet e Minsitrisë së Mbrojtjes për të bërë lidhjen me zonë e Skraparit, do i shërbejë komuniteti por do lidhë dhe dy rajone shumë të rëndësishëm në zonën tonë. Në lidhje me dëmet e tjera kemi patur dëme në disa kultura si grurë, vreshta, mollë, por kët išhin më sporadike në Kreshpan, Vreshtas, nuk kanë dëme të mëdha, në lidhje me grurin, lufta e vitit të kaluar trittit çmin dhe subvencionii nga qeveria ka bërë që gruri të mbillet me shumicë në fushën e Maliqit. Ajo çfarë unë mendoj është fermerët duhet të jenë vetë ekonomistë për çmimin, nuk duhet të synojnë gjithmonë çmimin e një viti më parë, kjo është ekonomi e hapur, tregu përeakton çminin, ne do jemi në mbështetje të tyre për kontrollin e mjeteve korse, urave, kanaleve etj. Të falenderoj për pyetjet. Do keni një informacion shumë të shpjetë për situatën në Plasë dhe Zëmlak.

**Ornildi Demollari:** Faleminderit! Po.

**Aleksandra Spaho:** Kisha dhe një pyetje në lidhje me dëmtimet, shumë fermërë ankohen që kompanitë e sigurimeve nuk na sigurojnë të mbjellat. Si mund të ndërhyjmë?

**Lulëzim Hoxhaj:** Po e jap unë përgjigjen për shqetësimin, nuk është e vërtetë, kompanitë e siugrimeve ju lutën sermeve, riskut i shmangen, por duhet të kesh dhe asete në pronësi.

**Petrif Kupe:** Doja të ndalesha pak te gruri, se në mbledhje ne radhë gruri është korur, çmimi këtë vit është sa gjysma e vitit të kaluar, çmimi i vitit të kaluar nuk mund të jetë më, për shkak të luftës në Ukrainë, por 27 lekë është shumë i ulët, është nën koston e prodhimit, duhet ta ngrejmë këtë problem dhe në qeveri ka mekanizma ekonomike qeveria, nëpërmjet tvsh-së dhe taksve doganore, një frenim i përkohëshëm i prodhimit që vjen nga jashtë i cili do ndikojë që prodhuesit e miellit të drejtohen drejt proshimit vendas.



REPUBLIKA E SHQIPÉRISË

**Ornildi Demollari:**Dakord! Kryetar kishe diçka?

**Kryetari i Bashkisë: z.Gëzim Topçiu:**Atë çka dua të them, çmimin e vendos tregu, patjetër që levat ndihmojnë dhe politika e qeverisë po ashtu, por duhet të dimë që dhe qeveria ka disa detyrime ndërkombëtare.Duhet parë nëse ka klauzola.Ne po mendojmë për ngritjen e pikave të grumbullimit, ajo çka ne po mendojmë dhe jemi gati ta bashkëfinacojmë për fermerët, është ngritja e silloseve të grurit në fushën e Maliqit dhe qeveria është dakord për të na mbështetur, kjo po zbatohet në zonën e Lushnjës, le të jetë ky një apel për të gjithë.

**Ornildi Demollari:**Besoj se jemi të gjithë bashkë në mbështetje të fermerit, le të përpinqemi me ato hapësira ligjore që kemi të jemi dakord të gjithë bashkë.Kemi diçka tjetër? Kjo ishte mbledhja për sot, ju uroj ditë të mbarë.

Mbledhja mbyllt!

### KRYETARI I KËSHILLIT

**Ornildi DEMOLLARI**

